



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN,
SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRIT RREGULLATOR**

Nr. 108 Prot.

Tiranë, më 08.01. 2019

Lënda: Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.780, datë 26.12.2018.

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORË

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

**Rektorit
Senatit Akademik
Bordit të Administrimit
Administratorit të Institucionit**

Të nderuar,

Në zbatim të vendimit nr.780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me qëllim njohjen me numrin e saktë të studentëve të kategorive të përcaktuara në VKM-në e përmendur më lart, si dhe një përlllogaritje të efektit financiar të kësaj VKM-je, kërkon bashkëpunimin tuaj për identifikimin e numrit të studentëve, si dhe përcaktimin e programit ku ata ndjekin studimet e tyre, të cilët plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë.

Konkretisht, na nevojiten të dhëna mbi numrin e studentëve që u përkasin kategorive të mëposhtme:

- Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Përpunimit, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë.
- Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore.
- Studentët, deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;
- Studentët, që kanë përfitur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
- Studentët, deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;
- Studentët, deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfitur statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore;
- Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;
- Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;
- Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);

- Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

Për zbatimin e këtij vendimi, nota mesatare vjetore, është mesatarja e ponderuar e përllogaritur nga institucioni publik i arsimit të lartë, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Lista e plotë e studentëve përfitues të dërgohet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Koli BELE

